

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

KA.nr.211/11

Datë: 26 Korrik 2011

Gjyqtari për konfirmim i EULEX-it Gunnar Øyhaugen, në rastin penal kundër

- ISUF IDRIZAJ, i biri i Skënder-it dhe nënë Shukrijes, lindur më 27 shtator 1979, në fshatin Kodrali, Komuna e Deçanit, shqiptar i Kosovës, në paraburgim prej 13 qershor 2010,
- DERVISH IDRIZAJ, i biri i Skënder-it, lindur më 04 maj 1984 në fshatin Kodrali, Komuna e Deçanit, shqiptar i Kosovës, në paraburgim prej 17 dhjetor 2010,
- BEDRI KRASNIQI, i biri Nezir-it, lindur më 10 shtator 1979 në fshatin Turjakë, Komuna e Pejës, shqiptar i Kosovës, në paraburgim prej 17 dhjetor 2010

Akuzuar në bazë të aktakuzës PP.no.217/10 të datës 9 qershor 2011, për veprat penale *Vrasje ne Tentativë* në shkelje të nenit 146 në lidhje me Nenet 20 dhe 23 të KPK-së kundër Dervish Idrizaj dhe Bedri Krasniqit dhe *Vrasjes së Rëndë ne Tentativë* në shkelje të nenit 147 pikat 4 dhe 9 në lidhje me Nenet 20 dhe 23 të KPK-së kundër Isuf Idrizaj, Dervish Idrizaj dhe Bedri Krasniqi,

Pas seancës për konfirmim të aktakuzës mbajtur më 25 korrik 2011, në përputhje me nenet 313 dhe 314 të KPPK-së, në praninë e Prokurorit Publik, të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës Gezim Kollcaku, Gezim Baloku dhe Klaus Kirchner, dhe në përputhje me Nenin 316 par. 4 të KPPK-së, Gjyqtari për Konfirmim lëshon si më poshtë

AKTVENDIM

KONFIRMOHET aktakuza e ngritur nga Zyra e Prokurorisë së Qarkut PP.nr.217/10 të datës 09 qershor 2011.

Aktakuza, bashkë me të gjitha dokumentet e dosjes së rastit duhet ti dërgohet Kryetarit të Trupit Gjykues për shqyrtimin kryesor, menjëherë pasi që ky aktvendim bëhet i plotfuqishëm.

Arsyetimi

Më 09 qershor 2011 Zyra e Prokurorisë së Qarkut ka ngritur aktakuzën PP.no.217/10 kundër të pandehurve Isuf Idrizaj, Dervish Idrizaj dhe Bedri Krasniqit për veprat penale *Vrasje ne Tentative* në shkelje të nenit 146 në lidhje me Nenet 20 dhe 23 të KPK-së dhe *Vrasjes së Rëndë ne Tentative* në shkelje të nenit 147 pikat 4 dhe 9 në lidhje me Nenet 20 dhe 23 të KPK-së. Më lartë është treguar cilat vepra penale janë të lidhura me secilin nga të pandehurit.

Pasi që aktakuza është parashtruar, gjyqtari për konfirmim, pas vlerësimit të saj në bazë të nenit 306 par. 2 të KPPK-së, gjen se aktakuza është hartuar në përputhje me nenin 305 të KPPK-së.

Gjyqtari për konfirmim ka caktuar seancën për konfirmim për 25 korrik 2011, për të cilën Prokurori Publik, të pandehurit dhe avokatët e tyre mbrojtës ishin ftuar. Pala e dëmtuar Valon Zukaj ishte thirrur po ashtu në seancë. Seanca ishte e hapur për publik.

Gjatë seancës për konfirmim Prokurori Publik ka lexuar aktakuzën para gjykatës. Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori Publik dhe pasi që gjyqtari ishte siguruar që të pandehurit e kishin kuptuar aktakuzën, të pandehurve ju ishte dhënë mundësia për tu deklaruar fajtor apo të pafajshëm.

Të pandehurit Isuf Idrizaj, Dervish Idrizaj dhe Bedri Krasniqi u deklaruan si të pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat që përfshinte aktakuza.

Në një parashtresë paraprake, avokati mbrojtës për Dervish Idrizaj kundërshtoi gjyqtarin Øyhaugen si gjyqtar për konfirmim në bazë të asaj që ai kishte qenë paraprakisht kryesues në një seancë për konfirmim që përfshinte klientin e tij. Prandaj ai parashtrroi një kërkesë për përjashtimin e gjyqtarit Judge Øyhaugen. Megjithatë, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it – Charles L. Smith III – lëshoi një vendim duke hedhur poshtë kërkesën e tij.

Në parashtresën e tyre, të tre avokatët mbrojtës kundërshtuan aktakuzën, duke propozuar gjykatës që aktakuza të refuzohet sepse nuk kishte prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin mirë të bazuar se të pandehurit kishin kryer veprat penale sipas aktakuzës (KPPK Nenet 316 (1) – 4).

Të pandehurit mbështetën parashtresat e avokatëve të tyre.

Konstatimet e Gjykatës

Gjyqtari për konfirmim nuk gjen ndonjë arsye për të hedhur poshtë aktakuzën sipas nenit 316 paragrafi 1 dhe 2, duke marrë parasysh se veprimet penale të përmendura në aktakuzë përbëjnë vepra penale, se nuk ekziston asnjë rrethanë për të përjashtuar përgjegjësinë penale, se parashkrimi nuk ka përfunduar, se aktakuza është ngritur nga një prokuror ligjor, se nuk ka asnjë rrethanë që ndalojnë ndjekjen penale – dhe se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin mirë të bazuar se të pandehurit kanë kryer veprat penale të përmendura në aktakuzë.

“dyshimi i bazuar” mund të përkufizohet si “*ekzistimi i fakteve apo të dhënave të cilat do të siguronin një vështrues objektiv se personi në fjalë mund të ketë kryer veprën penale*” – (KEDNj, Fox, Cambell dhe Hartley v. Mbretëria e Bashkuar, 30 gusht 1990, par.32).

“dyshimi mirë i bazuar” kërkon më shumë siguri sesa dyshimi i bazuar – pa arritur pragun e një fakti të vërtetuar. Gjykata Supreme e Kosovës (Mehmet Morina) shprehet si në vijim:

“Në këtë mënyrë, standardi duhet të jetë që provat e tilla që – pranohen – mund të shpijnë deri të një përfundim që është më shumë i mundshëm sesa që një vepër penale konkrete nuk është kryer. Në këtë drejtim, provat e mbledhura nga prokuroria duhet të jenë në gjendje që të sugjerojnë se të gjitha elementet e veprës penale janë kryer”.

Gjyqtari konstaton, sipas shkresave të lëndës dhe provave që mbajnë ato, se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një “dyshim mirë të bazuar” të tillë lidhur me të gjitha akuzat e ngritura në aktakuzë. Prandaj, neni 20 nga KPK duhet të zbatohet. Të pandehurit kanë vepruar bashkërisht në lidhje me këto tentim vrasje. Prandaj neni 23 nga KPK duhet të zbatohet.

Sipas shkresave të lëndës viktima Valon Zukaj ishte objekt i dy tentimeve të dështuara ndaj jetës së tij – e para më 23 shtator 2009 (Neni 146 të KPK-së) dhe e dyta më 11 qershor 2010 (Neni 147 të KPK-së 4 dhe 9). Në të dyja rastet një numër i të shtënave me armë zjarri janë qëlluar në drejtim të tij.

Në rastin e dytë ai ka marrë tre plagë me armë zjarri në kokë, por ai ka mbijetuar. Incidenti i dytë ka rezultuar me akuzën për tentim i vrasjes së rëndë - Neni 147 pikat 4 dhe 9. Veprimi penal i kryer përfshinte vënien në rrezik të jetës së djalit të tij 10 vjeçar – dhe gjithashtu kjo vepër duket të jetë një hakmarrje për lëndimin e shkaktuar ndaj Dervish Idrizaj.

Bedri Krasniqi:

Elementet e mëposhtme janë baza për gjyqtarin që të vërtetoj “dyshimin mirë të bazuar” lidhur me Bedri Krasniqin:

Vrasje ne Tentative – neni 146 të KPK-së – 23.09.200 rreth orës 18.50:

- Elementi më i rëndësishëm lidhur me “dyshimin mirë të bazuar” është dëshmia e viktimës – Valon Zukaj. Ai e ka identifikuar Bedri Krasniqin si njërin nga personat që ka arritur në supermarketin “Tropikana”, që gjendet përball “Shtëpisë së Shëndetit” në Deçan, dhe i cili ka dal nga një veturë BMW me ngjyrë të erret përderisa mbante një armë. Bedri Krasniqi pastaj qëndroi para Valon Zukaj dhe një kërkesë për para është bërë Valon Zukajt. Distanca në mes tyre ishte përafërsisht 5 metra. Bedri Krasniqi nuk tha asgjë dhe mbante revolen në dorën e djathtë të tij. Bedri Krasniqi ishte i njohur për viktimën,

Bedri Krasniqi kishte qenë bashkë me Dervish Idrizaj dhe një person i tretë jashtë “Tropikana”. Dervish Idrizaj ka qëlluar një herë më revolen e tij. Një plumb ka goditur Dervish Idrizaj në fytyrë të tij.

- Dëshmia e dëshmitarit – zyrtarit policor Murat Gervalla. Në ditën në fjalë ai kishte qenë në restorantin afër vendit të ngjarjes dhe kishte dëgjuar të shtëna me armë dhe kishte vërejtur një person i cili kishte shtëna me armë dhe duke ikur nga vendi i ngjarjes me një veturë BMW në drejtim të Gjakovës.
- Dëshmia e dëshmitarit – zyrtarit policor Faruk Civovic. Në ditën në fjalë ai kishte qenë në restorantin afër vendit të ngjarjes dhe kishte dëgjuar të shtëna me armë dhe

kishte vërejtur një person i cili kishte shtënë me armë dhe duke ikur nga vendi i ngjarjes me një veturë BMW në drejtim të Gjakovës.

- Dëshmia e dëshmitarit – Vedat Tahirsylaj. Ai kishte deklaruar se në ditën konkrete edhe ai gjithashtu ishte duke hyrë në supermarketin “Tropikana” kur kishte parë tre njerëz, dy nga të cilët ishin të armatosur me revole, ju kanë afruar z. Zukaj dhe kanë shkëmbyer fjalë me atë. Ai pastaj ka dëgjuar dy apo tre të shtëna me armë.

Vrasjes e Rëndë ne Tentative neni 147 të KPK-së – 11.06.2010 rreth orës 24.00:

- Elementi më i rëndësishëm lidhur me “dyshimin mirë të bazuar” është dëshmia e viktimës – Valon Zukaj. Ai e ka identifikuar Bedri Krasniqin si pësonin i cili gjendej në ulësen e pasme të veturës pasi që tejkaloi veturën e tij në rrugën nga Deçani në drejtim të Prishtinës në afërsi të fshatit Kliqinë. Një tjetër person nga ky automjet pastaj ka shkrepur me armë ën drejtim të tij duke e qëlluar atë tre herë në kokë. Ai e njihte Bedri Krasniqin më parë.
- Dëshmia e dëshmitarëve Avni Shala, Avni Gashi dhe Hetem Gashi. Ata kanë përshkruar se si kanë qenë duke udhëtuar në rrugën e njëjtë sikur Valon Zukaj dhe si kanë hasur në situatën pas incidentit me të shtëna. Ata kanë ndihmuar në marrjen e masave për ta dërguar në spital viktimën, Valon Zukaj.
- Dëshmia e dëshmitarit – zyrtarit policor Ahmet Neziraj. Ai ka shpjeguar se si në natën e incidentit ai ishte takuar me viktimën, Valon Zukaj në Deçan me kërkesën e tij. Valon Zukaj kishte thënë se ai po kishte vështirësi me Bedri Krasniqin dhe ai kishte kërkuar prej Ahmet Neziraj që të ndërmjetësoj në emër të tij. Dëshmitari Ahmet Neziraj u informua më pas për përpjekjen ndaj jetës së Valon Zukajt në po të njëjtën natë dhe ai e kishte vizituar atë në mëngjesin e ardhshëm në Spitalin e Pejës.

Dervish Idrizaj:

Elementet e mëposhtme janë baza për gjyqtarin që të vërtetoj “dyshimin mirë të bazuar” lidhur me Dervish Idrizaj:

Vrasje ne Tentative – neni 146 të KPK-së – 23.09.200 rreth orës 18.50:

- Elementi më i rëndësishëm lidhur me “dyshimin mirë të bazuar” është dëshmia e viktimës – Valon Zukaj. Ai e ka identifikuar Dervish Idrizaj si njërin nga personat që ka arritur në supermarketin “Tropikana”, që gjendet përball “Shtëpisë së Shëndetit” në Deçan, dhe i cili ka dal nga një veturë BMW me ngjyrë të errët përderisa mbante një revole. Dervish Idrizaj pastaj qëndroi para Valon Zukaj dhe një kërkesë për para është bërë. Valon Zukaj u përpoq që të ik dhe disa shkrepje me armë janë qëlluar nga revolja në drejtim të tij pa e qëlluar atë. Viktima– Valon Zukaj – u përgjigj me gjuajtje dhe një plumb e kishte goditur në fyt Dervish Idrizaj. Dervish Idrizaj ishte i njohur për – Valon Zukaj – nga fëmijëria e tyre në fshatin Kodrali.
- Dëshmia e dëshmitarit –zyrtarit policor Murat Gervalla. Në ditën në fjalë ai kishte qenë në restorantin afër vendit të ngjarjes dhe kishte dëgjuar të shtëna me armë dhe

kishte vërejtur një person i cili kishte shtënë me armë dhe duke ikur nga vendi i ngjarjes me një veturë BMW në drejtim të Gjakovës.

- Dëshmia e dëshmitarit – zyrtarit policor Faruk Civovic. Në ditën në fjalë ai kishte qenë në restorantin afër vendit të ngjarjes dhe kishte dëgjuar të shtëna me armë dhe kishte vërejtur një person i cili kishte shtënë me armë dhe duke ikur nga vendi i ngjarjes me një veturë BMW në drejtim të Gjakovës.
- Dëshmia e dëshmitarit – Vedat Tahirsylaj. Ai kishte deklaruar se në ditën konkrete edhe ai gjithashtu ishte duke hyrë në supermarketin “Tropikana” kur kishte parë tre njerëz, dy nga të cilët ishin të armatosur me revole, ju kanë afruar z. Zukaj dhe kanë shkëmbyer fjalë me atë. Ai pastaj ka dëgjuar dy apo tre të shtëna me armë.

Vrasjes e Rëndë ne Tentative neni 147 të KPK-së – 11.06.2010 rreth orës 24.00:

- Elementi më i rëndësishme është dëshmia e viktimës – Valon Zukaj. Ai e kishte identifikuar Dervish Idrizaj si personin i cili ishte në ulësen e parë të automjetit përderisa ishte në tejkallim të veturës së tij në rrugën nga Deçani në drejtim të Prishtinës në afërsi të fshatit Kliqinë. Dervish Idrizaj e hapi dritaren e derës së pasagjerit, ai ishte jashtë dritares dhe kishte një pushkë automatike– Kallashnikov. Ai qëlloi në drejtim të Valon Zukajt, duke e goditur atë tre herë në kokë. Valon Zukaj e kishte njohur Dervish Idrizajn që nga fëmijëria e tyre. Përkundër faktit që kjo kishte ndodhur natën në ora 24.00dhe ishte errësirë, Valon Zukaj ka shpjeguar në mënyrë logjike se si kishte arritur që ta identifikonte Dervish Idrizaj dhe të tjerët në automjet.
- Dëshmia e dëshmitarëve Avni Shala, Avni Gashi dhe Hetem Gashi. Ata kanë përshkruar se si kanë qenë duke udhëtuar në rrugën e njëjtë sikur Valon Zukaj dhe si kanë hasur në situatën pas incidentit me të shtëna. Ata kanë ndihmuar në marrjen e masave për ta dërguar në spital viktimën, Valon Zukaj.
- Dëshmia e dëshmitarit, zyrtarit policor Ahmet Neziraj. Ai ka shpjeguar se si në natën e incidentit ai ishte takuar me viktimën, Valon Zukaj në Deçan me kërkesën e tij. Valon Zukaj kishte thënë se ai po kishte vështirësi me Bedri Krasniqin dhe ai kishte kërkuar prej Ahmet Neziraj që të ndërmjetësoj në emër të tij. Dëshmitari Ahmet Neziraj u informua më pas për përpjekjen ndaj jetës së Valon Zukajt në po të njëjtën natë dhe ai e kishte vizituar atë në mëngjesin e ardhshëm në Spitalin e Pejës.

Iusuf Idrizaj:

Elementet e mëposhtme janë baza për gjyqtarin që të vërtetoj “dyshimin mirë të bazuar” lidhur me Isuf Idrizaj:

Vrasjes e Rëndë ne Tentative neni 147 të KPK-së – 11.06.2010 rreth orës 24.00:

- Elementët më të rëndësishme lidhur me “dyshimin mirë të bazuar” është dëshmia e viktimës – Valon Zukaj. Ai e ka identifikuar Isuf Idrizaj si personin i cili ishte vozitësi i veturës që tejkaloi veturën e tij në rrugën nga Deçani në drejtim të Prishtinës në afërsi të fshatit Kliqinë. Një tjetër shoqëruar i këtij automjeti pastaj

gjuajti me armë në drejtim të Valon Zukaj duke e qëlluar tre herë në kokë. Ai e kishte njohur Isuf Idrizaj qysh nga fëmijëria e tyre.

- Dëshmia e dëshmitarëve Avni Shala, Avni Gashi dhe Hetem Gashi. Ata kanë përshkruar se si kanë qenë duke udhëtuar në rrugën e njëjtë sikur Valon Zukaj dhe si kanë hasur në situatën pas incidentit me të shtëna. Ata kanë ndihmuar në marrjen e masave për ta dërguar në spital viktimën, Valon Zukaj.
- Dëshmia e dëshmitarit, zyrtarit policor Ahmet Neziraj. Ai ka shpjeguar se si në natën e incidentit ai ishte takuar me viktimën, Valon Zukaj në Deçan me kërkesën e tij. Valon Zukaj kishte thënë se ai po kishte vështirësi me Bedri Krasniqin dhe ai kishte kërkuar prej Ahmet Neziraj që të ndërmjetësoj në emër të tij. Dëshmitari Ahmet Neziraj u informua më pas për përpjekjen ndaj jetës së Valon Zukajt në po të njëjtën natë dhe ai e kishte vizituar atë në mëngjesin e ardhshëm në Spitalin e Pejës.

Bazuar në këto rrethana, Gjyqtari për Konfirmim gjen se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin **mirë të bazuar** se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat ata janë akuzuar dhe në këtë mënyrë konfirmon aktakuzën e ngritur.

Provat e pranueshme – të papranueshme:

Gjyqtari konstaton se nuk ka indikacione të qarta se ndonjëra nga provat e siguruara gjatë hetimeve janë të papranueshme. Prandaj nuk ka asnjë nevojë për ta shpallur ndonjë provë si të papranueshme. Nëse ndonjëri nga avokatët mbrojtës deklaroi se disa nga provat janë të papranueshme, kjo duhet të shqyrtohet dhe të vendoset si pjesë e shqyrtimit kryesor.

Prandaj është vendosur sikur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E QARKUT NË PEJË , KA.nr.211/11 datë 26 Korrik 2011.

